

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kantina Kinolli në "Serenights"/ Rakia dhe serenata, tradita që bashkojnë Korçën
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/kantina-kinolli-ne-serenights-rakia-dhe-serenata-tradita-qe-bashkojne-i474682
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 07:14:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 07:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2c0d4b0d39758948b6097c1c3d102b104752f0eacd880b3b99f8c9ccdcbfaf22c
TEKSTI	7a44df47fc3db6c3f4e4587ca2d6eb70ae2342495738d55af19ebb2474389e9c
PAMJA	2b184d93a758901afb4eb3fafbb7f0e7773e35619bcad6ab3c11b1d602fa4d62

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	69d6c65e30eef7db3ab1c6aa688ed0349785d10df52fc5cd02aa08b98230fb03
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a94744ba6f340a0d35e86c725f9a3ff2353c45c48cf148fa90ea824c18d037c8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/69d6c65e30eef7db3ab1c6aa688ed0349785d10df52fc5cd02aa08b98230fb03>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

09:08 Aktualitet

Përveç muzikës dhe serenatave, festivali “Serenights” në K...

Kantina Kinolli në “Serenights”/ Rakia dhe serenata, tradita që bashkojnë Korçën



20 Shtator 2026, 09:08, Aktualitet CNA



Përveç muzikës dhe serenatave, festivali “Serenights” në Korçë ka sjellë në vëmendje edhe traditën e produkteve shqiptare. Tradita dhe shija shqiptare janë bërë pjesë e këtij eventit të mrekullueshëm.



Mes bizneseve pjesëmarrëse është edhe Kantina Kinolli, e cila prej rreth 9 vitesh është e pranishme në treg me prodhimin e rakisë. Kantina ofron dy lloje produktesh, raki muskat dhe raki të vjetëruar në fuçi lisi për 3 deri në 4 vjet. Një traditë familjare, që tashmë po vijon me një brez të ri, i cili synon të promovojë dhe të çojë më tej këtë produkt tradicional shqiptar.

Andon Kinolli, përfaqësues i kantinës, tregon për produktet që ofrojnë, trashëgiminë familjare dhe lidhjen e veçantë mes rakisë, serenatave dhe mikpritjes korçare.



"Kantina Kinolli operon në treg prej rreth 9 vitesh dhe në treg sjell dy lloj rakish: raki muskat dhe raki të vjetëruar në fuçi lisi, e cila vjetërohet për 3-4 vjet në fuçi. Është një produkt shumë i mirë, produkt tradicional shqiptar. Dhe ne po mundohemi, si gjeneratë e re që jemi, që kemi marrë përsipër, po mundohemi ta ngremë sa më shumë lart", -tregon Kinolli.

Pas këtij aktiviteti qëndron edhe një histori familjare. Prodhimi i rakisë ka nisur nga babai i Andon Kinollit, i cili e përgatiste në mënyrë artizanale për miqtë dhe shokët. Më pas, këtë traditë e mori përsipër brezi i ri, duke vijuar procesin me të njëjtën dashuri për produktin. Kinolli tregon se prodhimi i rakisë kërkon njohuri dhe kujdes, por mbi të gjitha pasion për një proces që familja e tij e ka kthyer në pjesë të jetës së përditshme.

"Duhet të dish ato sekretet e saj. Është një proces shumë i bukur, që ne e adhurojmë, e dashurojmë shumë. Me këtë punë ka filluar babai im, i cili e nxirrte rakinë në mënyrë artizanale për shokë e miq. Më pas vazhduam ne", -shprehët Kinolli.

Pjesëmarrja në "Serenights" është një mundësi për të promovuar produktet e kantinës, por edhe për të qenë pjesë e një aktiviteti që lidhet ngushtë me traditën dhe kulturën e Korçës. Sipas Andon Kinollit, rakia dhe serenata kanë një lidhje të veçantë në jetën e qytetit, duke u bërë pjesë e atmosferës së festave dhe e mikpritjes korçare.



Përveç publikut vendas, një interes të veçantë për produktet tradicionale shqiptare tregojnë edhe turistët e huaj. Kinolli thotë se vizitorët e vlerësojnë rakinë dhe e mirëpresin atë gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri. Ndërsa për atmosferën e festivalit, ai shprehet entuziast, duke vlerësuar organizimin dhe artistët që janë ngjitur në skenë.



Mes tingujve të serenatave dhe atmosferës festive, "Serenights" krijon hapësirë edhe për promovimin e produkteve tradicionale shqiptare. Për Kantina Kinolli, pjesëmarrja në këtë aktivitet është një mundësi për të prezantuar punën dhe trashëgiminë familjare, duke e bërë rakinë pjesë të përjetimit kulturor që Korça u ofron qytetarëve dhe vizitorëve. Një ndërthurje e muzikës, traditës dhe shijes, që i jep festivalit një tjetër dimension dhe sjell në vëmendje vlerat që përcillen brez pas brezi./CNA




CNA.AL

SHANTAZHI NDAJ GAZETARES

Rrjeti SafeJournalists dhe Lala denoncojnë sulmin

sport

Përdorimi i rrjeteve sociale për komunikim të drejtpërdrejtë me tifozët pritet të ndryshojë mënyrat tradicionale të marketingut



AKUZAT NDAJ GAZETARES

13:19 ▼

Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë dënon sulmet ndaj Klodiana Lalës: Shantazhet ndaj gazetarëve nuk mund të tolerohen

MOTI SOT

PUKË: 10° / 13°



Të sugjeruara

Harta-Maratona "Little Paris" në Korçë/ Ja akset ku bllokohet qarkullimi

51 ditë protestë në Divjakë/ Qytetarët kundër ndarjes së re territoriale dhe shkrirjes së bashkisë

FOTOLAJM/ Pankartat në protestën e 112-të kundër qeverisë

Përfaqësues të FBI-së takohen me elitën e sigurisë në Tiranë/ Detaje nga agjenda

Ishin ndërtuar pa leje/ IKMT prish 4 objekte dy katëshe dhe një strukturë plazhi në Borsh

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.